




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "Promedia"

Nr. i biznesit 70347305

Pronar –Adrian Ballabani

OSHP ON TV

Ilaz Kodra nr. 35, (te Santea)

N.SH. "ON TV CHANNEL"

Nr. i biznesit 70936240

Pronar: Mehmet Elshani & Lulzim Elshani

Rr/Mark isaku nr. 44

Ref: 1509/1142/LIC/ni

### Vendim

për ndryshimin e pronësisë së Ofruesit të Shërbimeve Programore OSHP ON TV si dhe ndryshimin e emrit nga ON TV në ON TV Channel – me seli në Prishtinë

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. ON TV është Ofrues i Shërbimeve Programore, i cili është i licencuar për transmetimin e programit vetëm përmes rrjetit kabllorë. ON TV është pajisur me licencë të KPM-së për Ofrues të Shërbimeve Programore, me datën 5 dhjetor 2008.
3. Më datën 29 qershor 2015, pronari i OSHP ON TV z. Adrian Ballabani, ka parashtruar një kërkesë për ndryshimin e pronësisë duke e propozuar për pronarë të ri personin juridik N.SH. "ON TV CHANNEL" me pronarët z. Muhamet Elshani dhe z. Lulzim Elshani.
4. Me datën 18 shtator 2015, kandidati e ka kompletuar dokumentacionin, si pjesë përbërse e kërkesë për ndryshimin e pronësisë së OSHP ON TV.

5. Me anë të së njëjtës kërkesë, është kërkuar edhe ndryshimi i emrit nga OSHP ON TV me ndryshim në ON TV CHANNEL.
6. Me anë të një deklaratë, si pjesë përbërëse e kërkesës, kandidati për pronarë të “ON TV CHANNEL” ka theksuar se, përveç ndryshimeve në pronësi nuk do të ketë ndryshime në programin apo stafin të OSHP ON TV-së.

### **Arsyetimi**

7. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
8. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
9. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
10. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
11. Komisioni konstaton se, përveqë ndryshimit në pronësi të OSHP ON TV si dhe emrit nuk do të ketë ndryshime tjera, siç janë ndryshimet në skemën programore apo ndryshimet në stafin e kandidatit.
12. Komisioni konstaton se kandidati ka kryer të gjitha obligimet lidhur me tarifën vjetore të licencës së KPM-së.
13. Komisioni konsideron se, kërkesa e parashtruar për ndryshimin e pronësisë së OSHP ON TV është e kompletuar në pajtim me Rregullorën për Dhënjën e Licencës së KPM-së (KPM-213/04) dhe si e tillë, i përmbushë kushtet për miratim.
14. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se, kërkesa për ndryshimin e emrit të OSHP ON TV në ON TV Channel, i përmbush kriteret për ndryshim për faktin se emri i propozuar për ndryshim, ON TV Channel, nuk është i ngjajshëm me asnjë emër tjetër të ndonjë Shërbyesi Medial Audio Vizual të licencuar në Republikën e Kosovës, dhe në këtë mënyrë nuk paraqet konfuzion për shikuesit, perdorimi i tij për identifikim gjatë transmetimit.

### **Vendim**

15. Komisioni i KPM-së, me datën 20 tetor 2015, merr vendim për ndryshimin e pronësisë së OSHP ON TV dhe bartjen e licencës nga N.SH “Promedia” në N.SH. “ON TV Channel” si dhe licenca të ndryshohet.



16. Komisioni vendosë që të ndryshojë edhe emrin e ON TV në ON TV Channel, sipas kërkesës së kandidatit.

### Lëshimi i Vendimit

17. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.


Adnan MEROVCI  
Kryetar  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

27.10.2015  
datë